
04/07/2023

Oshënar Andrea i Kretës, himnograf



E martë, 4 korrik 2023 – Shenjtori i ditës.
Oshënar Andrea i Kretës, himnograf. Mihail Honiati i Athinës. Dëshmoret Kiprila, Aroa, Lukia.

– OSHËNAR ANDREA I KRETËS, HIMNOGRAF –

Himnograf shumë i shquar, i quajtur gjithashtu "jerusalemas". Lindi ndoshta më 660, në Damask, nga prindër të thjeshtë por shpresëtarë, Gjergji dhe Grigoria. Për herë të parë foli në moshën 8-vjeçare, me mrekulli.
Kur ishte 15 vjeç, u rreshtua në Manastirin e Shën Savës (afër Jerusalemit), ku u arsimua në teologji, muzikë, retorikë, filozofi, u qeth murg dhe veproi si sekretar patriarkal. Megjithëse i ri, u dërgua me dy jerondë në një mision zyrtar për te perandori në Konstandinopojë (685). Qëndroi në kryeqytet, u dorëzua dhjak në Kishën e Shën Sofisë dhe mori përsipër drejtimin e një jetimoreje dhe të një institucioni tjetër filantropik.
Në vitin 712 (ose më parë) e zgjodhën kryepiskop të 12 episkopatave të ishullit të Kretës, me seli kryeqytetin e saj, Gortina. Intelektual, por edhe praktik, aktivizoi

edhe këtu aftësitë e tij të mëdha. Mësoi popullin, bëri shkrime të ndryshme, ndërtoi kisha dhe shtëpi për të varfrit, të sëmurët e të huajt dhe organizoi Kishën. Njihen mrekullitë e tij në kohë thatësire dhe epidemie. Gjithashtu i dha zemër grigjës së tij, saqë zmbrapsën agresorin arab.
Luftoi për mbrojtjen e ikonave, por ashtu si miku i tij, shën Gjermanoi, më pas kryepiskop i Konstandinopojës (12 maj), u ndikua (712) për një kohë prej Monotelitizmit, degëzim i Monofizitizmit. Por më pas u pendua. I moshuar udhëtoi për në kryeqytet, ku u admirua retorika e tij. Gjatë kthimit, u lodh nga lundrimi dhe ndërroi jetë, siç e kishte parashikuar, në ishullin e Mitilinit, në verilindje të detit Egje. Atje e varrosën (rreth vitit 740).
Fjalimet e tij, festive zakonisht, lavdërojnë sidomos festat Hyjlindësore; veprat e tij himnografike përfshijnë muzikë “melos” dhe poezi “ode”, pra melodi, himnodi të “kanoneve” të shumta, “idhiomeleve” dhe “stihirareve”, madje shumica e konsideron si babain e “kanoneve”. “Kanoni i Madh” i tij shumë i famshëm (261 tropare) shfaq ashtu si gjithë krijimtaria e tij, njohuri të thella të Dhiatës së Vjetër dhe të Re. Njëkohësisht zbulon bollëk ndjenjash të njeriut që ngacmohet nga djalli. Pasuria letrare përfundon me thirrjen për pendim.
Andrea, greqisht do të thotë: burrëror.
* * * * *
– DËSHMORET KIPRILA, AROA DHE LUKIA –
Shën Kiprila ishte me prejardhje nga Kirini. Dy vjet pas martesës mbeti e ve për njëzet e tetë vjet. U shërua nga dhimbja kronike e kokës me lutjet e shën Theodhorit, prandaj u vu në shërbimin e shenjtorit bashkë me gratë e shenjta Lukia dhe Aroa.
U arrestua me dy shoqet e saj pas vdekjes së episkopit të shenjtë. Kiprilën e nxorën para gjyqit, por ngaqë refuzoi t’u sakrifikonte idhujve, i vunë thëngjij të ndezur në duar, ku ndezën temjan. Por shenjtorja tha: “Kjo nuk është sakrificë e vullnetshme!” Ushtarët ia mbanin me forcë dorën derisa të digjej e tëra. Kiprilën e varën në një shtyllë dhe e rrahën duke i shkaktuar të çara në trup; nga plagët e saj rridhte gjak, ndërsa nga gjinjtë, qumësht. Mes vuajtjeve të padurueshme, shenjtorja vdiq, duke marrë kurorën e pavyshkur. Të dyja shoqet e saj morën nga qeveritari lejen për ta varrosur trupin e shenjtores nën tingujt e psalmodhive të funeralit. Sapo e varrosën, vendi u mbulua nga një vesë që kishte veti shëruese. Shën Lukia dhe Aroa u ekzekutuan më pas, duke u bashkuar me Kiprilën në korin e të zgjedhurve të lavdishëm.

Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë